



## NJOFTIM PËR KONKURIM PËR VEND PUNE

Datë 15 /04/2019

Në zbatim të Ligjit nr.16, date 18/04/2018 “Për diasporën”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave për krijimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën nr. 469, datë 26.07.2018 si dhe Ligjit nr. 7961, datë 12. 7. 1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, QBD do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” konkursin për pozicionin:

### **Arkivist dhe Protokollist pranë QBD-së**

Kategoria e pagës për këtë pozicion është VII.

### **Përshkrimi përgjithësues i punës për këtë pozicion:**

1. Ndjek korrespondencën e QBD-së në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat” në Republikën e Shqipërisë, aktet e tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe rregulloren e QBD-së;
2. Merr në dorëzim dhe dërgon korrespondencën, e cila i drejtohet QBD-së dhe dërgohet prej saj;
3. Siguron që dokumentacioni që hyn në institucion të shpërndalet brenda ditës me qëllim që stafi të realizojë detyrat brenda afateve të caktuara duke kryer shënimet në regjistrat apo librat përkatës të dorëzimit;
4. Bën kopje dhe shumëfishim të dokumenteve dhe i shpërndan ato sipas porosisë në destinacionet e caktuara me qëllim njohjen me dokumentacionin nga ana e punonjësit të cilit i adresohet për ndjekje shkresa;
5. Siguron që shkresat e dala nga institucioni të shkojnë në destinacionin e caktuar duke ndërmarrë shënimet përkatëse në librin e postës;
6. Identifikon, indeksin, etiketon dhe klasifikon regjistrimet për ruajtjen fizike, me qëllim të lehtësojë aksesin dhe menaxhimin e arkivës;
7. Është përgjegjës për organizimin dhe planifikimin e punës në aktivitetin e arkivës;
8. Menaxhon përdorimin e vulës së QBD-së në mënyrë të kujdesshme dhe strikte në përputhje me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat” në Republikën e Shqipërisë dhe rregulloren e QBD-së.
9. Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga Drejtori i QBD-së në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda objektivave të punës.



### **Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e konkurimit publik:**

Të jetë shtetas shqiptar;  
Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;  
Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;  
Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;  
Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;  
Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;  
Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;

### **Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme sa vijon:**

- a - Të zotërojnë diplomë të nivelit "Bachelor" në Shkenca Juridike ose Shoqërore.
- b - Të kenë të paktën 2 (dy) vite përvojë pune në profesion;
- c - Të zotëroj një gjuhë të huaj. Preferohet anglisht.

### **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

Jetëshkrimi CV;  
Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara;  
Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);  
Fotokopje të letërnjoftimit (ID);  
Vërtetim të gjendjes shëndetësore;  
Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;  
Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave të bëhet brenda datës 26/04/2019, në Zyrën e Protokollit të QBD-së pranë Kryeministrisë dhe në postën elektronike të QBD-së [info@qbd.gov.al](mailto:info@qbd.gov.al)**

Në datën 30/4/2019, QBD do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për të vijuar me testimin, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.



Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për tu futur në dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga QBD për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

### **Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet**

#### **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" në Republikën e Shqipërisë;
- Njohuri mbi Ligjit nr.16, date 18/04/2018 "Për diasporën";
- Njohuri mbi VKM nr. 469, date 26.07.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën";

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

#### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv

#### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

### **Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e konkurimit**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Qendra e Botimeve për Diasporë (QBD) do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Shtetit për Diasporën,. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga QBD-ja, për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).